
ANALYSIS FOR THE PURPOSE OF CREDIT

Blerim Shehu

VTC Prizren, Kosovo, bshehu76@hotmail.com

Abstract: This topic addresses the financial analysis of a business for lending purposes. Often a business is analyzed as a potential borrower. The lending activity by the financial institutions is complex and in itself contains other elements besides the sound analysis of the financial statements. These other elements are: recognition of the applicant's activity for the loan or its past repayment. The handling of many elements will help the analysts with the purpose of lending.

The analysis of financial assets is done by banks, credit analysts for credit granting. The financial statements and the analysis of financial indicators in an enterprise is carried out to make decisions. The analysis of financial statements and financial indicators is carried out to assist in providing reports, explanations to make a decision about the enterprise, whether it is worthwhile to acquire the shares of the enterprise, whether it is a credible creditor, if the investment in the bonds society is most valuable. The following issues will be addressed in this topic. Interpretation of Balance Sheet for lending purposes, analysis of short-term assets and working capital, valuation of inventories in the balance sheet, their importance in the lending process, Interpretation of the size of the receivables and the accounts payable and Interpretation of the Statement of Income for Loan Purposes.

Keywords: Interpretation of the Statement of Accounts, Statement of Income, Statement of Cash Flows

ANALIZA ME QËLLIM KREDIDHËNIEN

Blerim Shehu

VTC Prizren, Kosova, bshehu76@hotmail.com

Abstrakt: Në këtë temë trajtohen analizat financiare të një biznesi për qëllime kredidhënien. Shpesh një biznes analizohet si një huamarrës potencial. Aktiviteti i dhënies së huave nga ana e institucioneve financiare është kompleks dhe në vetevete përmban edhe element të tjerë përveç analizës së mirëfilltë të pasqyrave financiare. Keto elemente të tjera janë: njohja e aktivitetit të aplikantit për kredi apo ndjekja e mëparshme e shlyrjes së saj. Trajtimi i shumë elementeve, do të ndihmon aplikuesit e analizës me qëllim kredidhënien.

Analiza e pasyrave financiare bëhet nga bankat, analistet e kredive për dhënie të kredive. Pasqyrat financiare dhe analiza e tregueseve financiare në një ndërmarrje kryhet për të marrë vendime. Analiza e pasyrave financiare dhe e tregueseve financiarë kryhet për të ndihmuar në dhënjen e raporteve, shpjegimeve të duhur për të marrë vendim në lidhje me ndërmarrjen, nëse ia vlenë të blihen aksionet e ndërmarrjes, nëse është një kredimarrës i besueshëm, nëse investimi në obligacionet e shoqërisë është më vlerë. Në këtë temë do të trajtohen çështjet e mëposhtme. Interpretimi i Bilancit për qëllim kredidhënie, analiza e aktiveve afatshkurtra dhe e kapitalit punues, vlerësimi i inventarëve në bilanc, rëndësia e tyre në procesin e huadhënies, Interpretimi i madhësisë së kërkesave për arkëtim dhe llogarive të pagueshme dhe Interpretimi i Pasqyrës së të Ardhurave për qëllime huadhënie.

Fjalët kyçe: Interpretimi i Bilanci Kontabël, Pasqyra e të ardhurave, Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

INTERPRETIMI I BILANCIT KONTABEL TË BIZNESIT PËR QËLLIM KREDIDHËNIE

Analiza e aktiveve afatshkurtra dhe e kapitalit punues.

Vlerësimi i inventarëve në bilanc, rëndësia e tyre në procesin e huadhënies.

Interpretimi i madhësisë së kërkesave për arkëtim dhe llogarive të pagueshme

Interpretimi i pasqyrës së të ardhurave për qëllim huadhënie.

Bilanci kontabël është një pasqyrë e cila paraqet gjithë të drejtat e një shoqërie dhe formën apo burimin e financimit të këtyre të drejtave të matura në një moment të caktuar në kohë, zakonisht me datë 31 dhjetor të çdo viti.

Nga këndvështrimi i analizës për kredidhënie, bilanci kontabël tërheq vëmendjen në lidhje me dy pika kryesore

- A po menaxhohet biznesi i aplikantit për kredi në mënyrë eficiente? A paraqitet bilanci kontabël i tij në gjendje të shëndetshme?
- Nëse biznesi përballet me probleme, a ka vlera të cilat mund të likuidohen për të mbuluar kredin?

Pikat më sipër përmbajnë çështje të rëndësishme për t'u shqyrtuar para se të merret vendimi në lidhje me aplikim kredie. Mënyrë e mirë për të interpretuar bilancin kontabël në kontestin e dhënies kredi është të shqyrtohet ecuria e tij nga një vit në tjetrin, duke iu përgjigjur pyetjeve :

- a) A janë rritur fitimet e pashpërndara dhe si po i investon ajo këto rezerva të akumuluar?
 b) A janë rritur aktivet e prekshme neto të shoqërisë?

Shqyrtimi i prirjes së zërave të bilancit kontabël e ndihmon analistin e kredisë të kuptoj më tepër në lidhje me strukturën financiare dhe pozicionin likuid të saj, të dyja këto shumë të rëndësishme për t'u kuptuar në thellësi dhe për të njohur biznesin deri në atë pikë sat ë krijohet siguria për t'i akorduar një kredi atij biznesi.

ANALIZA E FITIMIT TË PASHPËRNDARË

Fitimi i pashpërndarë raportohet në seksionin e kapitalit në pasqyrat financiare. Analiza e tij ndihmon të kuptohen më mirë disa momente të rëndësishme të jetës së biznesit.

Së pari, duke qenë se ky element përmbledh gjithë fitimet e mbajtura dhe të akumuluar në vite të cilat shoqëria ka zgjedhur t'i mbaj e riinvestoj dhe jo t'i shpërndajë. Kështu sa më të larta të jenë fitimet e pashpërndaraq më e vjetër është një shoqëri, dhe aq më të thella dhe të përkushtuara kanë qenë vendimet e marra nga drejtuesit. Një biznes i cili ka zgjedh të mos riinvestojë fitimin por ta shpërndaj atë tek aksionerët dhe që në mungesën e parë të fondeve drejtohet të marrë një hua, nuk krijon besim të madh tek bankat krahasuar me një biznes tjetër i cili ka zgjedh të ndjek një model riinvestimi të rregullt të fitimit që krijon dhe drejtohet pranë bankës për të marrë hua.

Së dyti, bashkë me primin e kapitalit, fitimi i pashpërndarë përfaqëson atë pjesë të kapitalit që në çdo kohë mund të shpërndahet si dividend. Zëra të tjerë të kapitalit si rezerva të ndryshme apo kapitali themeltar nuk lejohet të shpërndahen aksionerëve.

ANALIZA E AKTIVEVE FIKSE

Aktivitet afatgjate fikse të biznesit ndahen në tri grupe kryesore në bilancin kontabël: në aktive material, aktive jomateriale dhe aktive financiare.

Aktivitet materiale - këto janë vlera të cilat paraqesin investime të prekshme të biznesit të tilla siç janë: toka, ndërtesa, pajisje, makineri etj. Ky është një nga zërat më të rëndësishme të bilancit kontabël dhe duhet të tërheq menjëherë vëmendjen e analistit

Aktive jomateriale – këto janë në përgjithësi investime në element pa substancë fizike të prekshme siç janë: emri i mirë i biznesit, shpenzimet e kapitalizuara dhe patenta e licencat. Zakonisht vlerat e aktiveve jomateriale injorohen për efekte të analizës për kredidhënie, për arsye se nuk mund të shfrytëzohen si kolateral.

Aktivitet financiare (investime afatgjata) – këto paraqesin investime për më shumë se një vit në letra me vlerë të tregut apo hua të dhëna të tretëve. Analisti duhet të tregojë kujdes në shqyrtimin e përbërjes së investimeve afatgjata pasi disa herë ato mund të lihen si kolateral për disa lloje kredish.

ANALIZA E AKTIVEVE AFATSHKURTRA DHE E KAPITALI PUNUES

Struktura e zakonshme e aktiveve afatshkurtra dhe detyrimeve të afatshkurtra të një biznesi do të ishte si më poshtë:

AKTIVET AFATSHKURTRA

Mjetet monetare dhe ekuivalentë

Llogari të arkëtueshme

Dëftesa të arkëtueshme

Inventare

Investime afatshkurtra

Shpenzime të parapaguara

Kapitali punues paraqet diferencën e aktiveve afatshkurtra me detyrimet afatshkurtra. Duke supozuar se kapitali punues është një diferencë pozitive, atëherë arrihet në konkluzionin se aktivet afatshkurtra duhet të jenë me vlerë më të lartë se detyrimet afatshkurtra. Në përgjithësi për një analist të kredisë, kapitali punues paraqet një zë me interes sepse sa më i lartë që të jetë ai aq më i mirë konsiderohet pozicioni likuid i biznesit.

DETYRIMET AFATSHKURTRA

Overdrafti banker

Borxhe afatshkurtra, pjesa afatshkurtër e huave afatgjata

Dëftesa të pagueshme

Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

Tatime të pagueshme, dividendë të pagueshëm

Shpenzime të tjera të shtyra

VLERËSIMI I INVENTARËVE NË BILANC, RËNDËSIA E TYRE NË PROCESIN E KREDIDHËNIES

Inventarët janë një zë i mundshëm i bilancit kontabël që përdoret si kolateral. Duhet mbajtur në mendje se zakonisht inventarët janë të kapitalizuara me kosto, vlerë kjo që mund të mos reflektojë vlerën e inventarëve në treg. Për efekt të analizës inventari përbën një investim dhe i tillë duhet të matet efektiviteti i përdorimit të tij, matje e cila bëhet nëpërmjetë treguesit të qarkullimit të inventarit “ kosto e mallit të shitur / inventari mesatar”. Sa më i lartë ky tregues aq më mirë paraqitet biznesi. Me interes është shqyrtimi i prirjes së këtij treguesi për një periudhë kohe, prirje e cila mund të zbuloj aspektete të patreguara nga indikatorët e tjerë financiarë.

INTERPRETIMI I MADHËSISË SË KËRKESAVE PËR ARKËTIM DHE LLOGARIVË TË PAGUESHME

Kërkesat për arkëtim ndahen në kërkesa nga klientë tregtarë dhe kërkesa nga klientë të tjerë, ku këto të fundit janë zakonisht në një vlerë të neglizhueshme për shumicën e bizneseve. Kërkesat për arkëtim paraqesin rëndësi në procesin e kredithënies në të paktën në dy aspekte: 1. Aftësi e konvertimit të tyre në mjete monetare do t'i mundësoj biznesit huamrrës të shlyej fondet e marra hua 2. Ato mund të shërbejnë si kolateral për hautë afatshkurtra

Analiza e kërkesave për arkëtim kryhet duke llogaritur shpejtësinë e qarkullimit të tyre “shitje me kredi / kërkesa për arkëtim mesatar”. Ky tregues ndihmon të kuptohet madhësia e investimeve të biznesit në klient dhe kohëzgjatja mesatare e kredisë së dhënë atyre.

Zëri i bilancit kontabël “ llogari të pagueshme” paraqet madhësinë e financimit nga furnitorët. Në njëfarë mënyre financimi që biznesi merr nga furnitorët është një zvendësues i financimit në mënyrë direkte nga banka. Akumulimi i furnitorve tregon se shumë shpejt në të ardhmen do të vije koha kur ato do të shlyhen.

Analiza e llogarive të pagueshme kryhet duke llogaritur raportin e qarkullimit të furnitorëve “ blerje me kredi / llogari të pagueshme”. Nëse vihet re një ulje e këtij raporti dhe nëse kjo përbën një tendencë konsistente në analizën e aktiveve të biznesit sipas tremujorëve, atëherë duhet hetuar shkaku i kësaj. Nëse arsya e vërtetë nuk vjen prej përkeqësimit të aktivitetit të biznesit atëherë kjo nuk përbën sinjal paralajmërues.

INTERPRETIMI I PASQYRËS SË TË ARDHURAVE PËR QËLLIME HUADHËNIE

Pasqyra e të ardhurave të biznesit paraqet akumulimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të biznesit për një periudhë. Dhe rezultati i biznesit mund të llogaritet në shumë nivele në varësi të formatit të caktuar të pasqyrës së të ardhurave dhe nivelit të detajimit të të ardhurave e shpenzimeve. Përveç formatit njëhapësh të pasqyrës së të ardhurave, formati shumëhapësh në të gjitha versionet e tij ofron një larshmëri nivelesh të rezultatit, analiza e të cilës zbulon informacione të vlefshme në lidhje me një biznes.

Pavarësisht nga formati i organizimit dhe raportimit të pasqyrës së të ardhurave një biznes gjeneron të ardhurat kryesore nga shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve, dhe kryen pjesën më të lartë të kostove për të blerë mallrat dhe lëndët e para, paguar personelin dhe paguar interes.

Analiza e pasqyrës së të ardhurave me qëllim kredithënies fokusohet në këto pika kryesore:

- Tendencat e rezultatit dhe shitjeve
- Raporti fitim / shitje : marzhi bruto dhe marzhi neto
- Raporti kosto / shitje
- Raportet e mbulimit të interesave
- Raporti i fitimit ndaj madhësisë së biznesit

Nëse disponohen informacione për disa periudha ushtrimore, atëherë shqyrtohet tendenca në kohën e shitjeve, kostos së mallit të shitur dhe fitimit. Zakonisht një marzhë fitimi shumë i ngushtë konsiderohet i rrezikshëm sepse nuk lejon një interval të gjërë besimi dhe me përkeqësimin më të lehtë të aktivitetit, pra firma rrezikon të ketë humbje.

Përveç analizës së zërave specifik të të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e të ardhurave ofron informacion edhe për llogaritjen e një sërë raportesh të rëndësishme për analizën e huamarrjes. Raportet mund të paraqiten në formën më të thjeshtë të tyre si raport i aftësisë së firmës për të mbuluar interesat.

Tregues të tjerë të rëndësishëm që mund të ndërtohen, por që nuk bazohen vetëm në pasqyrën e të ardhurave por edhe në bilancin kontabël janë kthimi mbi investimet dhe kthimi mbi kapitalin e pronarit. Kthimi mbi investimet matet si “ fitimi operativ / aktive totale. Kthimi mbi kapitalin e pronarit matet “ fitimi neto / kapitalin e vet”.

ANALIZA E FLUKSEVE MONETARE

Flukset monetare janë shumë të rëndësishme kur shqyrtohet aftësia e biznesit për të mbuluar borxhet e saj. Më tepër se sa me fitimin, një tregues që fizikisht nuk ekziston, firma arrinë të akumuloj fonde për të shlyer huat nëpërmjet flukseve të parasë, tepricave neto të parasë, këta që i llogarit dhe i raporton pasqyra e flukseve të mjeteve monetare. Paqyra e flukseve monetare është e organizuar në tri kategori: aktivitet operativ, aktivitet investiv dhe aktivitet financiar. Flukset e parasë së një firme, arkëtimet dhe pagesat raportohen sipas këtyre tri klasave dhe për secilën prej tyre llogaritet fluksi i parasë neto. Shuma e flukseve të parasë nga aktivitetet e investimit, shfrytëzimit dhe financimit quhet fluksi neto i përgjithshëm i parasë dhe duhet të jetë i barabartë me ndryshimin e mjeteve monetare nga fillimi deri në fund të periudhës. Ka dy metoda për të ndërtuar pasqyrën e fluksit të parasë: metoda direkte dhe metoda indirekte. Metoda direkte është ajo e cila ofron informacion më të detajuar e të përshtatshëm për të kryer një analizë financiare të pastër. Metoda direkte raportet flukset bruto të parasë, arkëtimet sips burimeve të ndryshme dhe pagesat sipas destinacioneve kryesore. Metoda indirekte nuk raporton flukset bruto, por fitimit neto të periudhës i

bënë një sërë rregullimesh që synojnë të konvertojnë fitimin neto në fluks operativ të parasë, nëpërmjet disa rregullimeve të cilat në vetvete nuk janë flukse paraje dhe është e gabuar që të interpretohet si e tillë. Metoda direkte e raportimit të pasqyrës së flukseve të parasë paraqet shumat bruto të arkëtimeve dhe pagesave si më poshtë:

- Arkëtimet nga shitja e mallrave dhe produkteve
- Pagesa për blerjen e mallrave dhe materialeve
- Paga dhe shpërblimet e paguara
- Tatami mbi të ardhurat i paguar
- Interesi i paguar

Metoda indirekte llogarit fluksin operativ duke rregulluar fitimin neto si më poshtë :

Rezultati neto (nga pasqyra e të ardhurave)

Plus: zhvlerësimin / amortizimin / provizionet

Plus: humbjen / (fitimin) nga shitja e aktiveve afatgjate

Minus: (rritja) / zvogëlimi i inventarit (nga bilanci kontabël)

Minus: (rritja) / zvogëlimi i kërkesave për arkëtim

Plus: Rritja / (zvogëlimi) i llogarive të pagueshme

= Fluks neto të parasë nga aktiviteti i shfrytëzimit (në Pasqyrën e flukseve të parasë)

Kurse flukset kryesore të aktiviteve të investimit do të paraqiteshin si më poshtë:

- Blerjet dhe shitjet e AAM dhe AAJM
- Blerjet dhe shitjet e njësive të kontrolluara, filijaleve
- Huat e dhëna palëve dhe arkëtimet nga shlyerja e tyre
- Interesi dhe dividenda e arkëtuar

Flukset kryesore të aktiviteve financuese do të ishin:

- Marrje e huave dhe kthimi i tyre
- Ripagesat e qirasë financiare
- Emetimi i aksioneve
- Blerja / shitja e aksioneve të thesarit
- Pagesa e dividendëve

ANALIZA STRUKTURORE E FLUKSEVE MONETARE DHE ECURIA E TYRE

Në situatën kur pasqyra e fluksit të parasë është raportuar me metodën direkte është e mundur të bëhet analiza strukturore e flukseve të parasë duke i kategorizuar si arkëtime dhe pagesa. Kështu shqyrtohet secili zë i arkëtimeve se çfarë peshe zë në arkëtimet totale të biznesit dhe secili zë i pagesave se çfarë peshe zë në pagesat totale të biznesit. Kjo analizë strukturore zbulon se cili është kontribuesi kryesor në flukset hyrëse të biznesit, dhe analisti duhet të pres që kontribuesi kryesor të jenë arkëtimet nga klientët për shitje të mallrave e shërbimeve, si edhe sicili është destinacioni kryesor i pagesës së parave, dhe zakonisht pagesat bëhen kryesisht për të shlyer furnitorët tregtar, për paga dhe shlyerjet e kësteve të plota të huave. Nëse rezultoni ndojë burim tjetër i rëndësishëm i arkëtimeve të parave si edhe ndonjë destinacion i ndryshëm nga ato të përmendura më lartë, nuk duhet të nxitohemi të nxjerrim konkluzione se biznesi shfaq anomali operative, thjesht duhet të nxitemi të shqyrtojmë këtë strukturë arkëtimesh dhe pagesash për disa periudha me rradhë dhe të shohim nëse kjo veçori përbën një përjashtim të një viti të veçant apo më tepër një tendencë të qëndrueshme të aktivitetit të firmës. Shembull: Biznesi edhe pse ka aktivitet kryesor prodhimin janë thellësisht të angazhuar edhe në shitblerjen e letrave me vlerë në treg. Për një biznes të tillë nuk është anormale të kemi një sasi të lartë arkëtimesh nga interesat dhe shitja e aksioneve.

PËRMBLEDHJE

Pasqyrat financiare dhe treguesit financiarë të biznesit janë faktor kyç për të ofruar informacione për qëllime të kerkimit të kredive, shitje të aksioneve, obligacioneve të biznesit. Bilanci kontabel jap gjendjen financiare të biznesit në kohë të caktuar që zakonisht është fundi i vitit. Përmes zërave të bilancit kontabel marrim informata për aktivet afatshkurtëra, aktivet afatgjate, llogaritë e arkëtueshme, shpenzimet e parapaguara, mbi tërheqjet në bankë, huat afatshkurtëra, llogaritë e pagueshme, tatimet e pagueshme. Kapitali punuës paraqet diferencën ndërmjet aktiveve afatshkurtëra dhe detyrimeve afatshkurtëra. Për analistin e kredisë kapitali punuës paraqet një zë me interes sepse sa më i lartë që të jetë ai aq më i mirë konsiderohet pozicioni likuid i ndermarrjes.

Pasqyra e të Ardhurave pasqyron të ardhurat dhe shpenzimet e biznesit, diferenca mes këtyre jep rezultatin financiarë. Rezultatet pozitive për biznesin paraqesin fitimin e realizura gjatë një periudhe kohore. Është shumë me rëndësia se sa nga keto mjete riinvestohen në biznes apo sa është sasia e fitimit të shpërndarë. Pasqyra e flukseve të

parasë pasqyrojnë lëvizjet e mjeteve monetare, pra arkëtimet dhe pagesat e biznesit. Ketu shyrtohen secili zë i arkëtimeve se çfarë peshe zë në arkëtimet totale të biznesit dhe secili zë i pagesave se çfarë peshe zë në pagesat totale të biznesit. Pasqyrat financiare dhe analizimi i tyre japin informata te mjaftueshme per bankën dhe analistin e kredive për të aprovuar apo mos aprovuar kërkesë për kredi nga ana e biznesit.

LITERATURA

- Dhimiter N., Vjollca K., Etleva P., (2007) "Aditmi" SH.B. Libri Universitar Tiranë
Fridson, M. S., Alvarez F., (2011) "Financial Statement Analysis Eorkbook", Business & Economic
Suli, I., Perri R., (2008) "Analiza e pasqyrave Financiare", Tiranë
Xhafa, H., Ciceri B., (2006) "Drejtimi Financiar", Tiranë
Xhafa, H., (2005) Analiza e Pasqyrave Financiare, Tiranë
<http://ëëë.freebookcentre.net/Business/Accounting-Books.html>,